



REPUBLIKA E SHQIPERISË

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 1043/1 Prot.

Tiranë, më 17/04 /2025

V E N D I M

Nr. 19, datë 17.04.2025

P Ë R

**MIRATIMIN E PROJEKTEVE KËRKIMORE-SHKENCORE, PROPOZUAR PËR
PROGRAMIN E STUDIMIT TË CIKLIT TË TRETË “DOKTORATË” NË INXHINIERI
MATEMATIKE, TË RIORGANIZUAR, NË FAKULTETIN E INXHINIERISË
MATEMATIKE DHE INXHINIERISË FIZIKE, NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK TË
TIRANËS, PËR VITIN AKADEMIK 2025-2026**

Mbështetur në Ligjin Nr. 80/2015, datë 22.07.2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Vendimin Nr. 41, datë 24.01.2018, "Elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë", i ndryshuar, Udhëzimit të MAS Nr. 1, datë 14.01.2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të Arsimit të Lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit si dhe për ndarjen ose bashkimin e Institucionit të Arsimit të Lartë" i ndryshuar, VKM 112, datë 23.02.2018, e ndryshuar, Urdhërit të MAS Nr. 374, datë 23.07.2024, Rregulloren e Studimeve të Doktoratës të UPT-së dhe kërkesën e Fakultetit të Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike, Senati Akademik në mbledhjen e datës 17.04.2025,

VENDOSI:

Të miratojë projektet kërkimore shkencore me titull:

1. Solvency II dhe Implementimi në Tregun Shqiptar të Sigurimeve;
2. Ifrs 17: Përshtatja dhe Sfidat Aktuariale në Sistemin Shqiptar të Sigurimeve;
3. Mosbarazime Integrale të Funksioneve Konveks në Kalkuluesin Thyesor dhe atë Kuantik si dhe Aplikime të tyre;
4. Rezultate në Zbatimin e Ideal Konvergjencës në Teorinë e Masës dhe Integritimit;
5. Hulumtimi i Ndërveprimit ndërmjet Sistemeve Dinamike, Kaosit dhe Fraktaleve;
6. Studimi Krahasimor i metodave gjeostatike, me metodat e modelimit statistikor dhe teknologjia GIS në përpunimin dhe analizën e të dhënave hapësinore-rasti i ndotjes së mjedisit nga industria e naftës.

Propozuar për programin e studimit të ciklit të tretë "Doktoratë" në Inxhinieri Matematike, të riorganizuar, në Fakultetin e Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike, në Universitetin Politeknik të Tiranës, për vitin akademik 2025-2026.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Prof. Dr. Akli Fundo

